

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opštine Orahovac

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu

Data - Datum	13.02.2020
Referencë/a	08 nr.8/2020
Për/Za/To :	Bedri Haki Orllati nga Brestoci
Zona Kadastrale:	Brestovc
Përmes/ Prekp/Through:	Afrim Oruqi - Drejtor
Nga/Od/From/	Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Sektori për Pronë
	Vendim

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë K.K. Rahovec duke vendosur sipas kërkesës së Drejtorisë për Punë Inspektuese – Inspektori i Ndërtimtarisë 14 nr. 423/2020 më datë: 06.02.2020, me të cilën është kërkuar që të zhvillohet procedura e uzurpimit arbitrar në pronësinë shtetërore, kundër të dyshuarit Bedri Haki Orllati nga Brestoci, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit Mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pasurore të krijuar me uzurpim arbitrar të tokës në pronësinë shtetërore (“ Gazeta zyrtare e KASK ”, nr. 46/77 dhe 37/88), dhe nenit 21 të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 05/L-031, merr:

V E N D I M

I. VERTETOHET Se Bedri Haki Orllati nga Brestoci, ka zgjeruar kufirin e parcelës së vetë nr. 1007-2 në dëm të parcelës shtetërore nr. 1893-0, e cila evidentohet si P.Sh.e Kosovës K.K.-Rrugët Z.K. Brestovc, me të cilin ka ndërtuar objektin afarist duke bërë uzurpim arbitrar të pasurisë shtetërore, në sipërfaqe të përgjithshme prej 22 m².

II. Uzurpuesi arbitrar Bedri Haki Orllati nga Brestoci, është i obliguar që pjesën e parcelës së uzurpuara ta liroj me mënjanimin e objektit të ndërtuara, të cekura në pikën I të këtij vendimi dhe të njëjtën ta kthej në gjendjen e mëparshme, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendim.

III. Nëse i përmenduri në afatin e caktuar ligjor nuk e liron sipërfaqen e uzurpuar, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme.

IV. Uzurpimi është kryer në vitin 2019.

V. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të uzurpuesit arbitrar.

A r s y e t i m

Inspektori i ndërtimtarisë me kërkesën 14 nr. 423 më datë: 06.02.2020 ka njoftuar këtë drejtori se gjatë mbikëqyrjes së rregullt inspektuese mbi ndërtimin e objekteve pa leje në Komunën e Rahovecit përkatësisht në fshatin Brestoc, ka hasur tek Bedri Haki Orllati nga Brestovci ndërtimin e objektit të cekura në pikën I në dispozitivin e këtij vendimi, për çka dyshohet se ky ndërtim është bërë në pjesën e parcelën komunale nr. 1893-0 dhe ka kërkuar nga kjo drejtori të vërtetohet gjendja faktike në vendin e ngjarjes.

Drejtorja për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori për Pronë i K.K. Rahovec së bashku me gjeodezin e kësaj drejtorie kanë dal në vendin e ngjarjes dhe pas matjes dhe incizimit së parcelës komunale nr. 1893-0, dhe parcelës private nr. 1007-2, ka konstatuar se i përmenduri me veprimet që ka ndërmarr ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale në të cilën eksperti i gjeodezisë ka hartuar skicën e terrenit, me të cilën shihet qartë pozita, kufiri dhe sipërfaqja e uzurpuar.

I përmenduri në deklaratën e tij ka cekur se: me qellim nuk ka bërë kurrfarë uzurpimi, por se nuk e ka ditur vijën kufitare të parcele së vet, nëse vërtetohet se kam bërë uzurpim arbitrar, unë do të rrënoj pjesën e objektit të ndërtuar dhe se do të veproj komfor dispozitave ligjor në fuqi.

Kjo drejtori ka analizuar dhe vlerësuar faktet dhe në fund ka vendosur në këtë çështje administrative, pasi që gjatë matjes dhe incizimit të parcelës në fjalë të pasqyruar në skicën e terrenit, është vërtetuar se i përmenduri, ka bërë uzurpim arbitrar.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit mbi shqyrtim e marrëdhënieve pasurore të krijuar me uzurpim të tokës në pronësi shtetërore ("Gazeta Zyrtare e KASK", 46/77 dhe 37/88), është vërtetuar se i përmenduri ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale, të cekur në dispozitiv të këtij vendimi.

U vendos pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori i Pronës K.K. Rahovec, më datë 13.02.2020

08 nr. 8/2020

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës - Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimiit përmes kësaj drejtorie.

Hartuesi

Jur. i Diplomuar, Nazmi Krasniqi



Drejtori

Jur. Diplomuar, Afrim Oruqi






Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu

Department of Cadastre



Skica e terenit

Z.K. Brestovc

P/1:500

Bedri Haki Orllati-Brestovc

1007-2

Rrugë 1893-0

Me kërkesen e Drejtorisë për pun Inspektuese në Rahovec nr. 423 datë 06.02.2020 kam dalë në vend dhe kam kryer matjen-izimin e objektit që është në ndërtim dhe kam konstatuar se Bedri Haki Orllati nga Brestovci e ka zgjerruar kufirin e parceles së vetë nr. 1007-2 z.k. Brestovc në dëm të parceles nr. 1893-0 z.k. Brestovc që evidentohet në emër të P.Sh. e Kosov. K.K. Rahovec, Ruget, në sipërfaqe prej: $22m^2$ duke e ndërtuar objekt me material të fortë. Detaj i ngjyrosur me ngjyrë pembe markimi paraqet pjesen e parceles së uzurpuar me pjesen e objektit.

Rahovec me 11.02.2020



Miftar Krasniqi gjeom.